



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1563 / Prot.
3

Tiranë, më 08.08.2025

VENDIM QARKULLUES

Nr. 30, datë 08.08.2025

**“PËR MIRATIMIN E KOSTOS SË STUDIMIT TË PROGRAMIT TË INTEGRUAR
TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË “MJEKËSI E PËRGJITHSHME”, QË
OFROHET NGA FAKULTETI I MJEKËSISË NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË,
TIRANË”**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3 dhe neni 37 dhe 38; në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 527, datë 07.09.2023 “Për caktimin e metodologjisë së kostos së studimeve për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë dhe çdo mbështetje tjetër për studentët e këtij programi studimi”; në Statutin e UMT-së, neni 5 dhe neni 25, 26 dhe 27; në Rregulloren e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, neni 17, në Relacionin e Grupit të Punës me nr. 1563/1 prot., datë 07.08.2025 “Mbi analizën e kostos për programin e studimit “Mjekësi e Përgjithshme” në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2025-2026”, si dhe në Vendimin Qarkullues të Rektoratit të UMT-së me nr. 30, datë 07.08.2025, Senati Akademik i UMT-së nëpërmjet konfirmimeve të anëtarëve me e-mail (bashkëlidhur këtij vendimi),

VENDOSI:

1. Të miratojë koston e studimit të programit të integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme”, që ofrohet nga Fakulteti i Mjekësisë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë sipas tabelës më poshtë:

Të dhënat e kostos	Të dhënat për Fakultetin e Mjekësisë	Të dhënat sipas peshës specifike: Dega "Mjekësi e Përgjithshme"
Pesha Specifike	100%	60.56%
Kosto direkte		
Fondi për shpenzime personeli *	747,912,900	452,915,019
Shpenzime per bursa	122,040,000	102,600,000
Total kosto direkte	869,952,900	555,515,019
Kosto indirekte		
Shpenzime Kapitale 10% mbi fondin e pagave**	74,791,290	45,291,502
Shpenzime Operative 15% mbi fondin e pagave**	112,186,935	67,937,253

Total kosto indirekte	186,978,225	113,228,755
Total kosto (direkte + indirekte)	1,056,931,124	668,743,774
Numri i kuotave te certifikuara të studenteve MP viti akademik 25-26		2,586
Kosto për studentë (në lekë):		258,602

**Kjo vlerë ka dalë referuar PBA-së së FM, fondit të pagave të parashikuar për vitin 2026.*

*** Shpenzimet kapitale dhe operative janë marrë në vlerat minimale të parashikuara në VKM.*

Kosto totale/student = kosto direkte + kosto indirekte
= 214,816 lekë + 43,785 lekë
= 258,602 lekë;

- Vendimi i përcillet për miratim përfundimtar Bordit të Administrimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
PROF. DR. XHELADIN DRAÇINI

